



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE TATIMORE DHE KONTABILITETIT  
Sektori i Përpunimit të Deklaratave Tatimore, Vlerësimit dhe Rimbursimit

Nr. 36391 Prot.

Tiranë, më 2.11.2015

**Lënda:** Për deklarimin elektronik të punonjësve të pezulluar apo të larguar nga puna për më shumë se një muaj

**Drejtuar:** Drejtorisë Rajonale Tatimore \_\_\_\_\_

**Për dijëni:** Drejtorisë Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve  
Drejtorisë Kontrollit Tatimor  
Drejtorisë Auditit të Brendshëm  
Drejtorisë Teknike  
Drejtorisë Teknologjisë së Informacionit  
Drejtorisë Ligjore  
Drejtorisë Mbledhjes së Borxhit  
Drejtorisë Menaxhimit të Riskut  
Drejtorisë Hetimit Tatimor  
Drejtorisë Apelimit Tatimor  
Drejtorisë Avokatit të Tatimpaguesve  
Drejtorisë Administratës dhe Prokurimeve  
Zyra e Projektit

Këtu

Në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, deklarimi nga tatimpaguesit i detyrimeve për kontributet e detyrueshme të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, si dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, sipas kategorive të punonjësve, bëhet në sistemin informatik të organeve tatimore në rubrikat përkatëse të deklaratës "Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi", e miratuar me Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr.23, datë 9.12.2014 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore".

Me listëpagesën deklarohen të dhënat për personat që kanë lidhje me marrëdhëniet e punës dhe pagën gjatë muajit përkatës, për të cilat tatimpaguesi ka detyrimin për të llogaritur kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe tatim mbi të ardhurat nga punësimi.

Qëllimi thelbësor i deklarimit nga tatimpaguesi i të dhënave të listëpagesës të muajit përkatës është evidentimi i detyrimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, të çdo punonjësi, i cili mbi bazën e pagesës së kontributeve ka të drejtën për të marë përfitimet ligjore, nga skemat përkatëse, të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Punonjësit, të cilët për shkaqe të ndryshme, për më shumë se një muaj, janë të pezulluar nga puna, apo të larguar nga puna pa të drejtë page, për muajt e plotë të pezullimit apo largimit, nga tatimpaguesi të deklarohen në listëpagesë si të larguar nga puna dhe kur të rikthehen në punë të deklarohen si të punësuar rishtazi.

Këto veprime duhet të realizohen brenda afateve ligjore me anë të deklarimit në sistemin informatik të organeve tatimore të të dhënave sipas rubrikave të dokumentit “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”.

Drejtoria e Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve të marë masa për publikimin e kësaj shkrese në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al), në rubrikën e vendimeve teknike për kontributet.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**BRISIDA SHEHAJ**